



# **NDRYSHIMET NË PAKETËN E LIGJEVE TË REFORMËS NË DREJTËSI**

*Raport*



RAPORTI ËSHTË REALIZUAR NGA STAFI I ISP NË KUADËR TË PROJEKTIT

**REFORMA: PËR NJË RITËM CILËSOR**

Monitorim, sensibilizim dhe asistencë

MBËSHTETUR NGA PROGRAMI I REFORMËS NË DREJTËSI,  
FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË.

Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe të ISP.  
Ato nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

**Realizues**

**Stafi i ISP**

© Instituti i Studimeve Politike

Tiranë, korrik 2021

*INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE*

*web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)*

*Email: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al) dhe [contactaips@gmail.com](mailto:contactaips@gmail.com)*

*Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies*

*Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë*

## HYRJE

---

Instituti i Studimeve Politike (ISP), po monitoron prej vitesh progresin e reformës në drejtësi, përfshirë edhe jetësimin e legjisllacionit kushtetues dhe organik, si dhe të akteve nënligjore. Gjatë vitit të fundit ISP është fokusuar në projektin "Reforma: për një ritëm cilësor. Monitorim, sensibilizim dhe asistencë" është duke u zbatuar nga ISP me mbështetjen e programit të shtetit të së drejtës të fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Projekti monitoron institucionet kryesore të reformës, përfshirë Presidentin, Kuvendin, Qeverinë, KLGJ, KLP, ILD, etj. Pjesë e rëndësishme e këtij monitorimi janë edhe raportet periodike mbi ndryshime të rëndësishme, mungesa të akteve apo vonesa në nxjerrjen e tyre. ISP ka tërhequr disa herë vemendjen për vonesa të shumta kohore në jetësimin e hartës gjyqësore dhe për elementë të rëndësishëm të reformës.

Materiali në vijim lidhet me paketën e ndryshimeve ligjore në ligjet e reformës në drejtësi, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë gjatë pranverës së vitit 2021. Ndryshimet erdhën si rekomandime nga disa institucione dhe si mjet për zgjidhjen ose parandalimin e problematikave të mundshme në sistem. Ato u miratuan pa konsultime me shoqërinë civile dhe përmes një procedure formale parlamentare, shoqëruar edhe me përdorimin e vetos presidenciale ndaj tyre. Koha e miratimit ishte e njëjtë me periudhën kur në vendin tonë po zhvilloheshin zgjedhjet parlamentare dhe debati elektoral dominoi diskursin politik e publik, duke lënë në hije debatin mbi legjisllacionin në reformën në drejtësi.

Ndryshimet ishin aq të shpejta në procedurë dhe praktikën parlamentare sa që humbën rastin të vlerësojnë edhe rekomandime të tjera për ndërhyrje përmirësuese të ardhura nga institucione të tjera të reformës në drejtësi. Për pasojë, pas ndryshimeve në Kuvend janë depozituar nisma të tjera ligjore për ndërhyrje në ligje të caktuara të reformës në drejtësi, dhe së fundi është iniciuar edhe debati për ndryshime kushtetuese lidhur me mandatin e organeve të vettingut në drejtësi.

Ky material nuk analizon të gjithë spektrin e ndryshimeve, debateve dhe pritshmërive, por vetëm thelbin e ndryshimeve të jetësuar në parlament dhe ndikimin tyre specifik në sektorë apo në institucione të veçanta të qeverisjes së drejtësisë ose të reformës në drejtësi. Materiali është përgatitur nga eksperti ligjor i ISP-së.

## SFONDI I NDRYSHIMEVE LIGJORE

Shqipëria prej vitesh tashmë i është nënshtruar një procesi të vështirë reformues të sistemit gjyqësor, proces i cili ka prodhuar jo pak pakënaqësi dhe efekte anësore, të lidhura kryesisht me vonesat në proceset gjyqësore, si pasojë e mungesës së gjykatësve dhe prokurorëve për shkak të shkarkimit të tyre në vazhden e vetingut në radhët e gjyqësorit.

Gjendur përballë këtyre situatave, në dukje të paparashikuara, legjislatori shqiptar është përpjekur të plotësojë vakancat e krijuara me mënyra të ndryshme ligjore, duke krijuar njëkohësisht mekanizmat e duhur për funksionimin e hallkave të sistemit gjyqësor me stafin në detyrë të gjykatave dhe prokurorive.

Për këtë qëllim, ka lindur nevoja e miratimit të një pakete tjetër ndryshimesh ligjore, të cilat lidhen kryesisht me procedurën penale, civile dhe administrative, si dhe nga ana tjetër me rregullimin e disa aspekteve të rëndësishme të funksionimit të gjykatave dhe prokurorive.

Për sa më sipër, në Fletoren Zyrtare Nr.71, datë 14.05.2021 janë botuar një sërë ligjesh të cilat kanë ndryshuar aspekte të rëndësishme të sistemit gjyqësor në Shqipëri, si dhe ligje të tjera jo pak të rëndësishme, të tilla si Kodi i Procedurës Penale, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Civile, etj.

Më konkretisht, kjo paketë ligjore përbëhet nga ligjet, si më poshtë vijon:

1. *Ligj nr. 41/2021, datë 23.3.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;*
2. *Ligj nr. 42/2021, datë 23.3.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë";*
3. *Ligj nr. 43/2021, datë 23.3.2021, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;*
4. *Ligj nr. 44/2021, datë 23.3.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;*
5. *Ligj nr. 45/2021, datë 23.3.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar;*
6. *Ligj nr. 46/2021, datë 23.3.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";*
7. *Ligj nr. 47/2021, datë 23.3.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";*
8. *Ligj nr. 48/2021, datë 23.3.2021, "Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore";*
9. *Ligj nr. 49/2021, datë 23.3.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar;*
10. *Ligj nr. 50/2021, datë 23.3.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.*

Këto ndryshime të miratuara fillimisht nga Parlamenti nuk u mirëpritën nga organi i Presidentit duke bërë që ky i fundit me dekrete të posaçme të vendoste kthimin e tyre në Kuvend. Por, pavarësisht këtij fakti, sërish Parlamenti shqiptar vendosi rrëzimin e dekreteve të Presidentit, duke bërë që ligjet të miratoheshin përfundimisht dhe të hynin në fuqi, pas publikimit të tyre në Fletoren Zyrtare dhe pasi të kishin kaluar afatet përkatëse.

Sikurse e përmendëm edhe më sipër, këto ligje sjellin disa ndryshime të rëndësishme në drejtim të mundësitimit të një gjyqësori më fluid, në kushtet kur ky i fundit po përballet me një mbingarkesë pune dhe kërkesash, si pasojë e stafit të reduktuar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilëve i caktohen dosjet, si dhe nga ana tjetër, në kushtet kur rrezikohet të krijohet një situatë e paprecedentë në Shqipëri, ku aksesit në drejtësi nuk mohohet, por *de facto* rezulton i kufizuar për shkaqet e cituara.

*Më konkretisht, paketa e ligjeve të reja, ndër të tjera prezanton disa aspekte të rëndësishme, të cilat trajtohen në vijim:*

**1.** Lidhur me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vlen të theksohet fakti, se ky ligj ka sjellë disa ndryshime shumë të rëndësishme në raport të përbërjes së trupës gjyqësore në Gjykatën e Lartë. Referuar këtyre ndryshimeve, tanimë Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjyqësor të përbërë nga 3 gjyqtarë, ndërsa nga ana tjetër gjykon njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje me trup gjyqësor të përbërë nga 5 gjyqtarë dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore në kolegje të bashkuara. *Pra, ndryshe nga sa parashikohet më parë, se Gjykata e Lartë shqyrtonte rekursat në dhomë këshillimi me trup gjyqësor të përbërë nga tre gjyqtarë, tanimë Gjykata e Lartë gjykon jo më vetëm në dhomë këshillimi, por në kolegje me trup gjyqësor të përbërë nga 3 gjyqtarë.*

Gjithashtu, ky ligj ka parashikuar edhe një detaj tjetër shumë të rëndësishëm, të tillë si fakti se nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod. *Një ndryshim i tillë synon të garantojë paanësinë e gjyqësorit në Shqipëri, duke i dhënë palëve garancinë e duhur për një proces të rregullt ligjor, në zbatim të parimit të paanësisë së gjykatës.*

Nga ana tjetër, ligji është përpjekur të parashikojë edhe dënime për rastet e abuzimeve me kërkesat për përjashtimin e gjyqtarëve, duke luajtur kështu edhe një rol frenues në të tilla procedura të cilat shpeshherë shndërrohen edhe në abuzive nga palët në proces. *Lidhur me këtë aspekt, ligji parashikon se vendimi që deklaron të papranueshme kërkesën e përjashtimit ose që nuk pranon përjashtimin e gjyqtarit përmban edhe shpenzimet gjyqësore përkatëse, si dhe një gjobë deri në 50 000 lekë, në ngarkim të palës që, duke abuzuar, ka parashtruar një kërkesë të padrejtë.*



Ndërkaq, ligji ka prezantuar edhe një sërë mekanizmash të tjerë të cilët synojnë të perfeksionojnë Kodin e Procedurës Penale të tillë, si procedimet paragjykimore, të cilat *i japin të drejtën Gjykatës së Lartë që gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, t'i drejtohet Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut ose gjykatave të tjera ndërkombëtare*, apo edhe afate të specifikuara gjatë gjykimit, të cilat synojnë plotësimin e boshllëqeve ligjore në këtë drejtim dhe kufizimin e diskrecionit të gjykatës në zbatimin e procedurës.

**2.** Ligji nr. 42/2021, datë 23.3.2021, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"* ka sjellë dy ndryshime të rëndësishme në ligj. Më konkretisht, përmes këtij ligji parashikohet njësia e shërbimit ligjor, e cila ngrihet pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Ajo ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Prokurorisë së Përgjithshme duke përfshirë: *a) analizimin, studimin e ankimeve dhe dosjeve penale; b) përgatitjen e relacioneve për çështjet objekt gjykimi përpara Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese; c) kryerjen e kërkimeve ligjore; ç) përgatitjen e projektakteve; d) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjeve që i ngarkohen nga Prokurori i Përgjithshëm.*

Njësia e Shërbimit Ligjor është në varësi të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili cakton këshilltarin ligjor pranë një prokurori ose drejtorie në Prokurorinë e Përgjithshme, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tyre, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet tyre. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarët ligjorë, në të cilën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*.

Përmes këtij sektori, vihet re synimi i legjislatorit për të ndihmuar punën e organit të prokurorisë në kushtet kur mangësitë në burimet e tyre njerëzore janë qartazi të dukshme, si pasojë e procesit të vetingut në vazhden e reformimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, një element tjetër i rëndësishëm i ligjit është fakti se tashmë prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm do të kenë të drejtë të kenë akses të drejtpërdrejtë, si subjekte të interesuara, në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore, që përmbajnë informacionin e nevojshëm për hetimin e veprave penale që përfshihen në juridiksionin e tyre. *Qartazi edhe në këtë drejtim, ligji synon të përshpejtojë proceset hetimore nga ana e organit të akuzës, duke mos lënë hapësira të paplotësuara ligjore të cilat mund të shkaktojnë vonesa në përfundimin e proceseve hetimore penale.*

**3.** Ligji nr. 43/2021, datë 23.3.2021, "*Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ka prezantuar ndryshime në 4 vepra penale, e më konkretisht për veprën penale "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike", "Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", si dhe "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike". Këto vepra tashmë kanë të përfshirë në parashikimin e tyre një vlerë të caktuar monetare për kualifikimin e tyre, ç'ka përbën edhe ndryshimin më kryesor në raport me versionin e tyre të mëparshëm. Gjithashtu edhe masa e dënimit ka ndryshuar për këto vepra në varësi të rëndesës së veprës penale.*

Lidhur me veprën penale të *korruptsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike*, tashmë ligji parashikon se premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt *deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj* personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit. Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, është mbi vlerën 50.000 lekë, ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

E njëjta vlerë parashikohet edhe për veprën penale të *ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*. Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Ndërkaq, lidhur me veprën penale të *shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike*, tashmë specifikohet se kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tenderë dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, *kur tenderi ose ankandi publik është deri në vlerën 800.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj*, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, kur kryhet në tender ose ankande publike me vlerë mbi 800.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Nga ana tjetër, sa i përket veprës penale të *korruptsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike*, tashmë theksohet se kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë *deri në vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj*, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur përfitimi i parregullt ose premtimi i një përfitimi të tillë është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

**4.** Ligji nr. 44/2021, datë 23.3.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ka prezantuar disa ndryshime lidhur me aspekte të caktuara të zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, si dhe ka sjellë disa ndryshime tejet të rëndësishme në drejtim të zhvillimit të gjykimit për paditë me shumë të vogla.

Më konkretisht, tanimë me ndryshimet e reja Gjykata e apelit shqyrton me një gjyqtar të vetëm ankimet kundër vendimeve *për paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi*, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, ankimin e veçantë kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, ankimet e veçanta kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e veprimeve të përmbaaruesit gjyqësor, si dhe rastet e tjera të parashikuara në këtë Kod.

Nga ana tjetër, për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, *Gjykata e Lartë gjykon në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.*

Sa i përket procedurës së shqyrtimit të padive për shuma të vogla, tashmë parashikohet se *objekt i këtyre procedurave të përshpejtuara do të jenë të gjitha paditë të cilat kanë një vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, nga 150 000 Lekë që ishte.* Vihet re qartë në këtë pikë *tendenca e legjislatorit për të rritur vlerën e padive të cilat duhet t'i nënshtrohen procedurave të gjykimit të shkurtuar, me qëllim përshpejtimin e gjykimeve në gjykatat vendase.*

Ndërkaq, një ndryshim i ri tejet i rëndësishëm është edhe *procedimi paragjykimor*, një element ky i përfshirë edhe në Kodin e Procedurës Penale më ndryshimet e fundit. Ligji parashikon, se Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, mund të vendosin t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose gjykatave të tjera ndërkombëtare sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë Në një rast të tillë, ata marrin vendim për pezullimin e shqyrtimit të çështjes.

**5.** Ligji nr. 45/2021, datë 23.3.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, parashikon, ndër të tjera, se në rastet kur përpara emërimit gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzonte statusin e magjistratit, në përfundim të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë të caktohet të paktën në një pozicion në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ndërkaq, në kushtet kur sistemi gjyqësor në Shqipëri po vuan mungesën e stafit, ligji ka parashikuar se deri në emërimin e të paktën tre të katërtave të të gjithë gjyqtarëve të



Gjykatës së Lartë, por, në çdo rast, jo më vonë se data 31.12.2023, mbledhja e posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, është e vlefshme nëse marrin pjesë të paktën gjysma e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. *Përmes këtij ndryshimi vihet re se krijohen kushtet për vlefshmërinë e mbledhjes së posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në kushtet kur kjo e fundit ende rezulton e paplotësuar me numrin e duhur të gjyqtarëve për të siguruar një funksionim normal të saj.*

**6.** Ligji nr. 46/2021, datë 23.3.2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", reflekton në përmbajtjen e saj situatën e sistemit gjyqësor në Shqipëri, në drejtim të mangësive në burimet njerëzore. Për këtë qëllim, tashmë ligji i ri parashikon se gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe gjykata e posaçme, për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar të shkallës së parë dhe të apelit, *gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, ose me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, sipas parashikimeve të ligjeve procedurale.* Nëse bëjmë një interpretim sistematik të këtij parashikimi ligjor, lidhur me ndryshimet e fundit të bëra ndaj Kodit të Procedurës Civile dhe Penale, rezulton se *ky ndryshim është në të njëjtën frymë si ndryshimet e fundit të ligjeve procedurale.*

Edhe lidhur me mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve, është përfshirë tanimë togfjalëshi "gjyqtarët që ushtrojnë detyrën në atë gjykatë". Pra, mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve tashmë është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e anëtarëve që ushtrojnë detyrën në gjykatë. *Kjo me qëllim që të mos bllokohet veprimtaria e këtyre organeve, duke i mundësuar kështu kushtet e nevojshme për ushtrimin e detyrave të tyre edhe pse në mungesë të stafit të nevojshëm.*

*Ndërkaq, me qëllim ndihmesën e gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën, është parashikuar me ndryshimet e reja se pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit mund të funksionojë Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë, e krijuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.* Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton numrin e ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë duke u bazuar në domosdoshmërinë e tyre për mbarëvajtjen e punës në gjykatë, si dhe llojin e natyrën e çështjeve për t'u përpunuar dhe përgatitur nga ndihmësit ligjorë. Numri i ndihmësve ligjorë nuk mund të jetë më i madh se numri i përgjithshëm i gjyqtarëve.

Nga ana tjetër, ndryshimet e reja prekin edhe zëvendëskryetarin e gjykatës, për të cilin parashikohet tashmë se përjashtimisht, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas ligjit, *kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së shkallës së parë duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar, ndërsa kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së apelit duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar i gjykatës së apelit.*

**7.** Ligji nr. 47/2021, datë 23.3.2021, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"*, më së shumti prezanton disa ndryshime në drejtim të aspekteve financiare për trajtimin e anëtarëve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e më konkretisht të drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, Zëvendësdrejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, të hetuesit, oficerit të Policisë Gjyqësore, si dhe punonjësve.

Gjithashtu, ky ligj parashikon se me qëllim funksionimin normal të bërthamës komanduese elektronike në Prokurorinë e Posaçme caktohen specialistë të fushës, të cilët gëzojnë statusin e oficerit të Policisë Gjyqësore.

**8.** Ligji nr. 48/2021, datë 23.3.2021, "*Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore"*, parashikon sërish një ndryshim në drejtim të aspektit financiar lidhur me pagën e oficerit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, duke shfuqizuar parashikimin e mëparshëm që specifikonte se paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit është 20 % më e lartë se paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të seksioneve, e llogaritur mbi pagën bruto fillestare oficerit të Policisë Gjyqësore të seksionit.

**9.** Ligji nr. 49/2021, datë 23.3.2021, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*, të ndryshuar, sikurse edhe ndryshimet e tjera të kryera ndaj kodit të procedurës civile dhe penale, synojnë të përmirësojnë funksionimin e gjykatave në një situatë kur sistemi gjyqësor nuk gjendet në nivelin e duhur operacional sa i përket burimeve njerëzore.

*Më konkretisht, me ndryshimet e reja, ligji parashikon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet, me përjashtim të rekurseve të paraqitura kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit që kanë shqyrtuar padi ndaj aktit nënligjor normativ, si dhe gjykimeve në seancë gjyqësore për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, të cilat gjykohen me 5 gjyqtarë.*

Edhe ndryshimet e tjera ligjore specifikojnë procedurën e zhvillimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, duke filluar nga mënyra e depozitimit të rekursit, e deri në rastin e njësimit dhe ndryshimit të praktikës gjyqësore. *E gjitha kjo për të mundësuar parashikime sa më të sakta procedurale, me qëllim garantimin e plotë të një procesi të paanshëm gjyqësor.*

**10.** Ligji nr. 50/2021, datë 23.3.2021, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar, trajton gjithashtu disa aspekte të rëndësishme financiare për subjektet e këtij ligji, e veçanërisht për rastet kur magjistratët delegohen në gjykata të tjera për kryerjen e detyrave të tyre, si pasojë e mungesave në stafin e sistemit gjyqësor.

*Një situatë e tillë e karakterizuar fuqimisht nga mangësitë në radhët e gjyqësorit ka shkaktuar edhe ndryshimin e kriterëve të pranimit të kandidatëve për formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës përmes ligjit të ri. Më konkretisht, nëse më parë një kandidat duhet të kishte përfunduar, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë "Master i shkencave", si dhe të kishte dhënë provimin e shtetit për jurist në Shqipëri, tani më mjafton që kandidati të ketë përfunduar me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershëm me to.*

Gjithashtu, një kriter tjetër që ka ndryshuar për pranimin e kandidatëve për formimin profesional në Shkollën e Magjistraturës është edhe dënimi penal. Nëse më parë, kandidati që rezultonte i dënuar me një vendim të formës së prerë nuk kualifikohej për formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, tashmë mjafton që kandidati të mos jetë dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose prokurorit ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal.

Një element tjetër i rëndësishëm i këtij ligji është edhe parashikimi se magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Ndërkaq, parashikohet gjithashtu se magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. *Rrjedhimisht, tashmë specifikohet shprehimisht se statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë.*

Pra, nga sa më sipër, vihet re një përpjekje e legjislatorit për të përshtatur legjislacionin aktual me situatën e paprecedentë që po kalon vendi, e për shkak të së cilës janë prodhuar vonesa në drejtim të zhvillimit të procesit të rregullt ligjor.

Efektiviteti i këtyre ndryshimeve të fundit në paketën e ligjeve të reformës në drejtësi natyrisht që do të kërkojë kohën e duhur për t'u evidentuar, por ajo që është e rëndësishme të theksohet është fakti, se pritsmëritë nga qytetarët dhe bizneset janë të larta në drejtim të një gjyqësori të pavarur, e mbi të gjitha të pa korrumpuar.

Nga ana tjetër, vlen të përmendet se për implementimin e këtyre parashikimeve, si dhe për mbarëvajtjen e procesit reformues të sistemit gjyqësor në Shqipëri, është evidentuar edhe interesi i shtuar i përfaqësuesve të Bashkimit Europian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri. Kjo pasi, një sistem gjyqësor i drejtë, i paanshëm, i pakorrumpuar dhe mbi të gjitha efektiv, natyrisht që prodhon një interes të shtuar të investitorëve të huaj për të kryer investime në Shqipëri, si dhe nga ana tjetër, shërben si një themel i konsoliduar i shtetit të së drejtës dhe demokracisë, e si një garant i sistemit check and balance.

